

 INFRAKOS SH.A.
INFRAKOS D.D.
INFRAKOS J.S.C.
2
Nr.No.Br. 2197
Dt. 14.12.2023
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje



NDËRMARRJA PUBLIKE

- INFRASTRUKTURA E HEKURUDHAVE TË KOSOVËS - INFRAKOS SH.A -

RREGULLORE ***MBI PAGAT DHE KOMPENSIMET TJERA***



Fushë Kosovë
2023

Në mbështetje të nenit 20 të Ligjit nr. 04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në përputhje me Ligjin e Punës në Kosovë Nr. 03/L- 212, në mbështetje të nenit 15, paragrafi 15.2.3 pika (a), të Statutit të NP INFRAKOS Sh.A nr. 2/62 të dt. 02.08.2023, me qëllim të rregullimit të politikës së pagave dhe kompensimeve tjera të ndërmarrjes konform praktikave të mira të qeverisjes korporative, si dhe në përputhje me nevojat dhe gjendjen ekonomike, financiare dhe operative të ndërmarrjes, Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës - INFRAKOS SH.A, më datë 27/10/2023 aprovon këtë:

RREGULLORE

MBI PAGAT DHE KOMPENSIMET TJERA NË „INFRAKOS” Sh.A

Neni 1

Dispozitat e përgjithëshme

- 1.1 Me këtë Rregullore rregullohen pagesat mujore dhe kompensimet tjera të cilat iu bëhen punëtorëve të „Infrakos” Sh.A konform obligimeve dhe përgjegjësisë të tyre për kryerjen e detyrave të punës dhe të drejtave për realizimin e të ardhurave nga puna e tyre.
- 1.2 Kjo Rregullore është nxjerrë në pajtim me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës dhe Rregulloren mbi marrëdhëniet e punës të „Infrakos” Sh.A
- 1.3 Rregullorja vlen dhe do të zbatohet për të gjithë të punësuarit në „Infrakos” Sh.A.

Neni 2

Pagesat mujore

- 2.1 Për punën të cilën e kryen, punëtori i „Infrakos” Sh.A merr pagën mujore.
- 2.2 Të drejtën për pagë mujore, pagë shtesë, kompensim për punë jashtë orarit, kompensim për punë të natës, dhe kompensime tjera të parapara me këtë rregullore, i punësuar i realizon sipas marrëveshjes së arritur me „Infrakos” SH.A për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës.
- 2.3 INFRAKOS SH.A obligohet t'i paguajë të gjithë të punësuarve kompensimin e njëjtë për punën e vlerës së njëjtë, kompensim i cili mbulon pagën bazë dhe shtesat e tjera.

Neni 3

Kriteret për përcaktimin e pagës bazë

- 3.1 Paga mujore është e përcaktuar në bazë të kriterëve përcaktues si janë:
 - Kualifikimi shkollor i nevojshëm për vendin e punës.
 - Ndërlíkueshmëria e punës në pozitën përkatëse.
 - Rëndësia e pozitës sipas përgjegjësisë në procesin e punës.
 - Rrezikshmëria në punë (ky kriter do të mbështetet në faktorët të cilët do të përcaktohen nga organet kompetente të Republikës së Kosovës).
 - Kushtet e punës dhe intensiteti i punës.
 - Kryerja e punëve dhe detyrave të punës për „Infrakos” Sh.A jashtë shtetit të Republikës së Kosovës
 - Kualifikimet e brendshme të domosdoshme dhe kualifikime specifike për pozita të caktuara.
- 3.2 Kriteret e lartë cekura vlerësohen nga Komisioni i brendshëm i „Infrakos” Sh.A me rastin e përcaktimit të pagave bazë.

Neni 4
Kategorizimi dhe poentimi i vendeve të punës

Tabela e kategorizimit të pagave në INFRAKOS Sh.A është shtojcë e kësaj rregullore.

Neni 5

- 5.1 Pagat mujore paguhen një herë në muaj dhe këtë më së largëti deri me datën 5 të muajit të ardhshëm.
- 5.2 Punëdhënësi duhet të nxjerrë një deklaratë për çdo pagesë dhe çdo shtesë tjetër të paguar të punësuarve.
- 5.3 Pagat në „Infrakos” Sh.A paguhen përmes transferit bankar ndërsa regjistrat mbi pagesat e bëra i mbanë punëdhënësi.
- 5.4 Në çdo rast punëtori sipas kërkesës së tij mund të merr edhe dëshminë me të dhënat mbi pagën mujore.

Neni 6
Praktikantët

Për punëtorët të cilët themelojnë marrëdhënie pune në cilësi të praktikantit, paga mujore për kohën sa gjenden në stazhin e praktikantit është në lartësi prej 80% të pagës së punës për vendin në të cilin ka themeluar marrëdhënie pune.

Neni 7
Praktikantët pa pagesë

INFRAKOS SH.A në marrëveshje me personin e interesuar mund të angazhojë praktikant pa ndonjë kompensim të pagës dhe të drejtave të tjera nga marrëdhënia e punës, përveç që duhet të ofrojë mbrojtje dhe siguri në vendin e punës sipas ligjit. Punëdhënësi i cili e angazhon praktikantin pa kompensim page, është i obliguar ta evidentojë praktikantin në listën e evidencave pa kompensim page.

Neni 8
Puna provuese

- 8.1 Punëtori i cili ka themeluar marrëdhënie pune të rregullt në një pozitë të cilën nuk e ka ushtruar me pare është i obliguar të kalojë nëpër punën provuese.
- 8.2 Gjithashtu punëtori i cili krijon marrëdhënie pune në „Infrakos” Sh.A përmes konkursit publik, dhe i cili nuk ka qenë më parë punëtor i kësaj kompanie do të kalojë nëpër punë provuese.
- 8.3 Gjatë punës provuese punëtori merr pagën mujore të plotë, të paraparë për atë vend pune.

Neni 9
Kompensimi për punë me orar të plotë

- 9.1 Për punën e kryer me orar të plotë punëtori do të merr pagën mujore sipas kategorizimit të vendeve të punës (Tabelës së poentimit dhe kategorizimit e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje).
- 9.2 Kalkulimi i pagës mujore do të bëhet nga zyrtari i pagave dhe kompensimeve tjera dhe do të bazohet në evidencën e kohës së punës e cila punohet nga mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë të punëtorëve dhe vërtetohet nga zyrtari i personelit- Sektori i Resurseve njerëzore.
- 9.3 Afati i fundit për dorëzimin e evidencave të punës në Sektorin e Resurseve njerëzore është data e fundit e muajit.

Neni 10
Kompensimi për punë shtesë

- 10.1 Për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, i punësuar ka të drejtë në kompensim shtesë, në pajtim me këtë rregullore, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës.
- 10.2 Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si më poshtë:
- 2.1. 20 % në orë për kujdestari;
 - 2.2. 30 % në orë për punë gjatë natës;
 - 2.3. 30 % në orë për punë jashtë orarit;
 - 2.4. 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe
 - 2.5. 50 % në orë për punë gjatë fundjavës.
- 10.3 Puna që kalon mbi 40 orë në javë për punëtorët e „Infrakos” Sh.A konsiderohet punë jashtë orarit dhe llogaritet në shkallën 30 % mbi bazën.
- 10.4 Puna jashtë orarit kërkohet me shkrim nga Drejtori i departamentit . Kërkesës për organizimin e punës jashtë orarit i bashkëngjitet arsyetimi me shkrim. Vendimin për lejimin e punës jashtë orarit e merr Kryeshefi Ekzekutiv. Bazat e organizimit të punës jashtë orarit janë të përcaktuara me LPK.
- 10.5 Dokumentacioni mbi lejimin e punës jashtë orarit i dorëzohet Sektorit të Resurseve njerëzore bashkë me evidencën e kohës së punës.
- 10.6 Nga Sektori i Resurseve njerëzore mund të verifikohen rrethanat e organizimit të punës jashtë orarit dhe të vlerësohet domosdoshmëria e organizimit të saj.

Neni 11
Kompensimi për punë të natës dhe punë në fundjavë

Orët e punës prej orës 22:00 deri në orën 06:00, konsiderohen punë nate dhe paguhen në lartësi prej 30% mbi bazën për orë.

Neni 12
Kompensimi për punë gjatë festave zyrtare

Puna në ditët e Festave Zyrtare kompensohet me pagesë shtesë në shkallën 50% mbi bazën, ose me ditë të lira në shkallë të njëjtë me pagesën shtesë.

Neni 13
Kompensimi për pushime dhe zëvendësime

- 13.1 Pagesa për kohën e pushimit vjetor, pushimeve statusore dhe pushimit me pagesë është e barabartë me pagën bazë për vendin e punës.
- 13.2 Kur punëtori pa pëlqimin e tij caktohet në punë dhe detyra tjera të punës sipas nenit 18 pika 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të Ligjit të punës në Kosovë nr. nr. 03/L-212 i takon e drejta në diferencë të pagës.

Neni 14
Komisione për kryerjen e punëve të veçanta

- 14.1 Kryeshefi Ekzekutiv me vendim themelon komisione për kryerjen e punëve të veçanta të cilat do të kompensohen.
- 14.2 Kompensimi i komisioneve bëhet me pagesën e orëve shtesë, në rastin kur puna e komisionit kryhet pas orarit të punës.
- 14.3. Për komisionet që kujdestarojnë, caktohet një shumë fikse për kompensim.
- 14.4. Komisioni i rasteve të jashtëzakonshëm i emëruar nga Kryeshefi Ekzekutiv do të paguhet për secilin rast në shumën prej 50 euro.

Neni 15
Kompensimi i pushimit mjekësor

- 15.1 I punësuar në rast të sëmundjes ka të drejtë në pushim mjekësor të rregullt mbi bazën, deri në njëzet (20) ditë pune brenda një (1) viti me kompensim prej 100 % të pagës.
- 15.2. I punësuar ka të drejtë në pushim mjekësor pa pagesë me kërkesën e tij. Në këtë rast për kohën e mungesës në punë pa kompensim të pagës, të punësuarit i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtave të cilat burojnë nga pagesa e detyrueshme e kontributeve nga ana e të punësuarit(neni 40 i Ligjit të punës në Kosovë).
- 15.3. I punësuar i cili gjendet në pushim mjekësor për shkak të lëndimit në punë ose kur shkakët e sëmundjes së tij janë të lidhura drejtpërdrejtë me punët dhe detyrat e tij të punës, do ti bëhet kompensim i pagesës mujore në lartësi prej 70% nga pagesa e tij mujore. Pagesa e të ardhurave personale në shkallë 70% me rastin e lëndimit në punë bëhet në bazë të dokumentacionit dëshmuar të mjekut dhe zgjat në përputhje me dispozitat e Ligjit të Punës.
- 15.4 Shëndeti dhe siguria në punë rregullohet me dispozitat e Ligjit nr. 04/l-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë.
- 15.5. I punësuar ka të drejtë në kompensim të pushimit mjekësor sipas paragrafit 17.4. të këtij neni në kohëzgjatje prej dhjetë (10) deri në nëntëdhjetë (90) ditë pune.
- 15.6. Pagesa për kompensimin e pushimit mjekësor bie mbi „Infrakos” Sh.A
- 15.7 Pushimi mjekësor llogaritet me ditë pune.
- 15.8. Dispozitat e këtij neni do të jenë të aplikueshme deri në kohën e hyrjes në fuqi të legjislacionit për mbrojtjen dhe kujdesin shëndetësor.

Neni 16
Kompensimi gjatë pushimit të lehonisë

- 16.1 Gjashtë (6) muajt e parë të pushimit të lehonisë pagesa bëhet nga punëdhënësi me kompensim 70% të pagës bazë.
- 16.2 Tre (3) muajt në vijim, pushimi i lehonisë paguhet nga Qeveria e Kosovës me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë .
- 16.3 Femra e punësuar ka të drejtë që ta zgjasë pushimin e saj të lehonisë edhe për tre (3) muaj të tjerë pa pagesë.

Neni 17

Mungesa në punë për shkak të pasigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit dhe kompensimi

- 17.1. Me vendim të organit të autorizuar shtetëror ose organit të autorizuar të „Infrakos” Sh.A, për shkak të pasigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë, i punësuarit ka të drejtën e mungesës me arsye nga puna.
- 17.2. Gjatë mungesës së përkohshme në punë për shkak të pasigurisë në vendin e punës, të punësuarit i takon e drejta e kompensimit të pagës të cilën do ta kishte realizuar sikur të kishte punuar, por jo më gjatë se dyzet e pesë (45) ditë në vitin kalendarik.

Neni 18

Kompensimet për udhëtime zyrtare

- 18.1 Udhëtimet zyrtare jashtë vendit, në hekurudhat fqinje ose në shtetet tjera për qëllime zyrtare dhe në interes të „Infrakos” Sh.A duhet të paguhet nga ana e „Infrakos” Sh.A.
- 18.2 Udhëtimet zyrtare për stafin e Infrakos, aprovohen nga Kryeshefi Ekzekutiv.
- 18.3 Për çdo udhëtim duhet plotësuar formën e autorizimit për udhëtimin zyrtar.
- 18.4 Mëditja për udhëtimet jashtë vendit do të paguhet në bazë të tarifave të përcaktuara nga Qeveria e Kosovës.

Neni 19

Kompensimi për jetë të ndarë

- 19.1 Punëtorët të cilët nga „Infrakos” Sh.A janë dërguar jashtë vendit (Republikës së Kosovës) për të kryer punët dhe detyrat e tyre të punës në gjatësi kohore mbi 30 ditë, do të kompensohen për jetë të ndarë nga familja.
- 19.2 Vlera e kompensimit caktohet me vendim të veçantë të Kryeshefit Ekzekutiv të „Infrakos” Sh.A por nuk mund të jetë më e madhe se $\frac{1}{2}$ e pagës mujore të punëtorit.

Neni 20

Kompensimi gjatë suspendimit

- 20.1 Punëtorit i cili për shkak të lëndimit të obligimeve të punës i është shqiptuar suspendimi si masë parandaluese gjer në vendimin definitiv të komisionit disiplinor do ti kompensohet pagesa mujore në vlerë prej $\frac{1}{2}$ të pagës së tij mujore.
- 20.2 Punëtorit të cilit i është shqiptuar suspendimi si masë disiplinore do ti kompensohet paga në vlerë prej $\frac{1}{2}$ të pagës së tij dhe këtë deri i në përfundimin e masës së suspendimit.
- 20.3 Në rastin nga pika 21.1 nëse pas përfundimit të shqyrtimit disiplinor punëtori shpallet i pa fajshëm dhe lirohet nga përgjegjësia disiplinore atij do ti kompensohet pjesa e pagës e ndalur gjatë kohës së suspendimit (largimit të përkohshëm).

Neni 21

Kompensimi për mosshfrytëzim të pushimit vjetor

- 21.1 Pushimi vjetor duhet të kompensohet në rastin kur punëtori i cili për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës nuk e ka shfrytëzuar pushimin vjetor. Në këtë rast kompensimi bëhet për aq ditë pushimi sa i kanë mbetur pa i shfrytëzuar.

- 21.2 I punësuari që nuk e ka shfrytëzuar pushimin vjetor apo një pjesë të pushimit me fajin e punëdhënësit, ka të drejtë për ta shfrytëzuar atë pushim gjatë periudhës vijuese e cila i konvenon punëmarrësit, ose të kërkojë kompensim i cili caktohet varësisht nga kohëzgjatja e pushimit vjetor të pashfrytëzuar sipas të ardhurave të cilat i punësuari i realizon për muajin kur kompensohet .
- 21.3 Për të realizuar të drejtën nga pika 21.2, punëtori është i obliguar të ketë dëshmi me shkrim (kërkesën për lejimin e pushimit vjetor të refuzuar nga mbikëqyrësi), në mënyrën e paraparë nga dispozitat ligjore të LPK.
- 21.4 Rregulla nga pika 21.2 nuk vlen për punëtorët të cilëve iu ka ndërpre marrëdhënia e punës për shkak të shkeljeve disiplinore.

KOMPENZIMET E VEÇANTA

Neni 22

- 22.1 Të punësuarve në „Infrakos” Sh.A me vendim të Bordit të Drejtoreve mund të ju takojnë edhe kompensime të veçanta e të cilat nuk janë obligative sipas legjislacionit në fuqi (pagesa e përvojës së punës, pagesa e shujtës ditore, pagesa e shpenzimeve të udhëtimit etj).
- 22.2 Të punësuarve në „Infrakos” Sh.A ju njihet provoja e punës, dhe e njëjta do tu kompensohet sipas legjislacionit në fuqi dhe kësaj Rregulloreje. Në rast se Kompania bie në krizë financiare, do të shqyrtohen mundësitë për vazhdimin apo ndërprerjen e kompensimit të provojës së punës.

Neni 23

Kompensimi për shkak të shkuarjes në pension

- 23.1 Punëtorit për shkak të marrëdhënies së punës për shkak të shkuarjes në pension „Infrakos” Sh.A i ndajmë një kompensim në vlerë tri pagave mujore të llogaritura në vlerën e mesatares të tri pagave mujore të realizuara nga punëtori në tre muajt e fundit.
- 23.2 Me rastin e daljes në pension, punonjësit i jepet një dhuratë simbolike deri në vlerën 100 euro.

Neni 24

Kompensimi për raste të vdekjes së punëtorit

Me rastin e vdekjes së punëtorit, familjes së tij i ndahet një kompensim në vlerë prej 1.000€.

Neni 25

Stimulimi në punë dhe rreth punës

- 25.1 Kompania mund të stimulojë punëtorin nëse ai me punën e tij dhe angazhimin e tij personal ka sjellë rezultate të reja fitimprurëse për Infrastruktura të Kosovës „Infrakos” Sh.A.
- 25.2 Kompania në kuadër të mundësive financiare mund të ndihmojë – shpërblejë punonjësit e saj me rastin e viteve jubilarë të përvojës në punë.
- 25.3 Kompania në kuadër të mundësive financiare mund të mbulojë shkollimin e stafit të saj kur cilësohet në interes të kompanisë. Në këtë rast kompania duhet të lidh kontratë me përfituesin e shkollimit për shërbim të detyrueshëm në Kompani.

Neni 26

Reprezentacioni

- 26.1 Të drejtën në reprezentacion e kanë Bordi i Drejtorëve, Kryeshefi Ekzekutiv, udhëheqësit e Departamenteve dhe në raste të veçanta edhe zyrtar tjerë të Kompanisë.
- 26.2 Kryeshefi Ekzekutiv aprovon kërkesën për shfrytëzimin e reprezentacionit për të gjithë stafin e Kompanisë duke marr parasysh pozitën e zyrtarit dhe vlerën e reprezentacionit.
- 26.3 Në rast të funksionimit të bufësë në kompani, funksionimi dhe mënyra e shfrytëzimit të saj rregullohet me udhëzim të veçantë.

Neni 27

Dispozitat përfundimtare

- 27.1 Në rast mospajtimi në kuptimin e dispozitave, Zyra Ligjore bënë interpretimin përfundimtar të dispozitave eventuale dhe rregullores.
- 27.2 Për çështjet procedurale të cilat nuk janë të definuar plotësisht Kryeshefi Ekzekutiv mund të nxjerrin Udhëzime për mënyrën e procedimit.
- 27.4 Me aktet tjera që aprovohen nga Bordi i Drejtorëve mund të parashihen kompensime tjera që nuk janë të përcaktuara me këtë rregullore.
- 27.3 Të gjitha çështjet lidhur me pagat që nuk janë të përcaktuara apo përfshira me këtë rregullore, rregullohen me legjislacionin primar dhe sekondar, aktet e përgjithshme dhe konkrete të brendshme të punëdhënësit;
- 27.4 Të gjithë punonjësit e ndërmarrjes janë të obliguar që punën dhe veprimtarinë e tyre ta zhvillojnë në përputhje me legjislacionin primar, sekondar, standardet profesionale dhe aktet e brendshme të ndërmarrjes;
- 27.5 Rregullorja mund të rishikohet dhe bëhet plotësim-ndryshimi i saj nga Bordi i Drejtorëve, sipas propozimit të Kryeshefit Ekzekutiv apo me vetëiniciativën e bordit të drejtorëve;
- 27.5 Në rast të kolizionit apo mospërputhjes së dispozitave të kësaj rregullore me dispozitat e legjislacionit të aplikueshëm në fuqi, dispozitat ligjore kanë përparësi dhe të njëjtat duhet të zbatohen nga stafi kompanisë dhe përmes kryeshefit ekzekutiv duhet të informohet bordi i drejtorëve;

Neni 28

- 28.1 Kjo rregullore hyn në fuqi me 01.01.2024.
- 28.2 Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet rregullorja mbi pagat dhe kompensimet tjera të „INFRAKOS” Sh.A nr. 2/35 të datës 29.06.2022



Znj, Edona NAHI
Kryesuese e Bordit të Drejtorëve
Të Ndërmarrjes Publike Infrastruktura e Hekurudhave
të Kosovës - INFRAKOS SH.A